

S T A T U T I S H O Q E R I S E "E.B.S " SHPK

Me vullnet të lire të pote e të sinqerte, bazuar ne vendimin nr. 2 date 15 Prill 2007 te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve te shoqerise " PROJEKSION " shpk, nepermjet te cilat eshte miratuar ndarja e shoqerise " PROJEKSION " shpk ne tre shoqeri, ate ekzistuese dhe dy shoqeri te reja " E.B.S " shpk dhe " PROJEKSION ENERGJI " sha ,
z.Anastas RISKA, i biri i Skenderit, dtl.17.10.1962, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit me numer Z1208259, madhor dhe me zotesi te pote juridike per te vepruar, ne respektim te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
ne respektim te ligjit 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ",
ne respektim te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993, " Per registrin tregtar ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, ka hartuar kete statut te shoqerise " E.B.S " shpk (shoqeri me perqejjesi te kufizuar), me poshte e quajtur "Shoqeria "

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria " E.B.S " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perqejjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar ne gjykatën kompetente, ne përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, eshtë perqejje ndaj te tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë se saj.

Shoqeria " E.B.S " shpk, eshte nje e tille, kapitali i se cilës ndahet ne kuota dhe që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri ne kufirin e vlerës se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Laknas. Laprake.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Projektme dhe ndertime veprash ujitesesh, objektesh banimi, shoqerore, turistike, rruge kanalizime, ujesjellesa, e te tjera.

- Investime në fushen e ndertimit. Punime dhei me punime eventuale m urature e b eton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar; prodhim materiale inerte-gure, prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshem, paranderur, gere dekorative; ndertime civile dhe ekonomike; ndertime rrugesh; ndertim ura dhe vepra arti, ndertime portuale, bankina, basene, pontile; ndertime ujesjellesa, kanalizime, kanale e impiante vaditjeje, ndertim diga; vepra te vecanta e punime speciale; punime restaurimi; punime karpentierie; instalimi i impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare, mirembajtja e tyre; instalimi i materialeve prej druri, metali, plastike, xhami, etj.; punime bojatisje, hidroizolimi, termoizolimi, akustike, kundra zjarrit; pastrimi i siperfaqeve urbane; kryerja e punimeve ne sherbesat funerale.
- Prodhim dhe tregtim materialesh ndertimi.
- Import-export dhe tregtim (shitblerje) me shumice e me pakice i te gjitha mallrave qe lejon legjislacioni i Republikes se Shqiperise (sidomos mallra industriale, ushqimore dhe jo ushqimore, artikuj shtepiake e shkolllore, artikuj kozmetike e parfumerie, artikuj elektroshtepiake e elektrokulturore, pajisje dhe atrecatura per industrine e lehte, konfektione e tekstile, automjete e mjete te tjera transporti, pjese kembimi automjetesh, pajisje e makineri te ndryshme, kompjutera e pajisje te tjera informatike.
- Import-export dhe tregtim (shitblerje) me shumice e me pakice i p ajisjeve per sistem ngrohje, ftohje, ventilim, ajerim dhe klimatizim.
- Instalimi i pajisjeve per sistem ngrohje, ftohje, ventilim, ajerim dhe klimatizim.
- Shfrytezimi i Centraleve Elektrike per prodhimin e Energjise Elektrike dhe Energjive te tjera.
- Prodhimi, transformimi, transmetimi, shperndarja, shitja dhe blerja e energjise elektrike dhe energjive te tjera.
- Import – eksporti i energjise elektrike dhe lendeve energjitetike.
- Shfrytezimi dhe mirembajtja e pajisjeve, makinerive te prodhimit dhe ato ndihmese, te shoqerise dhe per te trete.
- Zgjerimi, modernizimi dhe riparimi i objekteve energjitetike dhe i rrjetit te pajisjeve perkatese.
- Ndertimi i objekteve per shfrytezin e burimeve te tjera per prodhimin e energjise elektrike.
- Kryerja e aktiviteve per studimin, projektimin, keshillimin e konsultimin per aktivitetet e peraktuara ne pikat e mesiperme.
- Kryerja e operacioneve tregtare, te cilat lidhen drejtpersedrejti ose terthorazi me objektin e saj, duke perqatitur bilancin finanziar, i cili do te mbahet i ndare vetem per kete objekt te veprimtarise se shoqerise.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqipetar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise, sipas raportit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar eshte **13.219.114 leke** (trembedhjet milion e dyqind e nentembetdhet mijë e njeqind e katermbetdhetë), dhe eshte i ndare në 100 pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave eshte 132.191,14 lekë, i zotuer nga ortaku i vetem

Anastas Riska kuota me vlere te **pergjithshme 13.219.114 leke**, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as më kontribute në shërbime.

Ortaku/permisja për humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre, sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se 100.000 leke, (vlera minimale e kapitalit themeltar të kësaj forme shoqërie) e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Qrtaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,
Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Zyres se Regjistrat Tregtar per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administratori

Administrator i shoqerise eshte Anastas Riska.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti I administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhëniet si dhe të bëhen dorëzënë apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortaku ka të drejtë të ndjeki në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti finançiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë finançiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividente

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finançiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rrëth shperndarjes se dividenteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finançiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Eksperter

Eksperi ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejtor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit ekspertri kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finançiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku, i cili jo vetejn qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se përegullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbisin dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilën eshte krijuar sic mund të jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Në kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerë prej tij emrin e likuidatorit që emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqëri të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërise të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja.

Ortaku i vetem i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërise të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërise që zhduken marjen e cilësisë së ortakëve të shoqërise përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrat Tregtar.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreve.shje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "E.B.S" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të cilit vertetohet nga Noteri.

ORTAKU I VETEM

Anastas RISKA

Anastas RISKA

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1930 Rep.
Nr. 389 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 23 Prill 2007 (dymije e shtate), perpara meje Noteres Publike **Blerina AVRAZI**, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me adresë Rr."Durrësit", pall.204, u paraqit personalisht shtetesi me keto identitetet :

z. Anastas RISKA, i biri i Skenderit, dtl.17.10.1962, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit me numer Z1208259, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, me vullnetin e tij te lire e të plete dhe të sinqerte ka redaktuar jashtë kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise statutin e mesiperm dhe pasi e lexoit ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tij ne kete zyre , para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne figura këtij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994.
" Per Noterin " ne Republikën e Shqiperise.

NOTERE
Blerina AVRAZI

